

Vendim nr. 154, datë 07.05.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sandër Beci, Anëtarë, në datën 07.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (A) 2026 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ALBERT ZEKAJ**, përfaqësuar nga avokatja Etlanda Petritaj, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 62-2020-2700 (242), datë 28.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 51, datë 11.03.2021 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-973 (153), datë 12.06.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 18, 30, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 71, pika 1, 71/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi D.B. ka kallëzuar në polici se ai dhe familjarët e tij kanë humbur kontaktet me vëllain e tij K.B., që prej muajit qershor të vitit 2017, duke hedhur dyshime se ai mund të

ishte vrarë nga shoku i tij, Albert Zekaj (*kërkuesi*), me të cilin jetonte në një banesë. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (*Prokuroria e Fierit*) në datën 06.02.2018 ka regjistruar procedimin penal nr. 219, për veprën penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal (*KP*) mbi bazën e materialit hetimor të dërguar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ndërsa në datën 11.08.2018 ka regjistruar procedimin penal nr. 1006, për veprën penale “Vjedhja”, të parashikuar nga neni 134/1 i *KP*-së. Këto procedime janë bashkuar në një procedim të vetëm, atë me nr. 16 të vitit 2018. Pas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore, si këqyrja e automjetit të viktimës, kryerja e ekspertimeve mjeko-ligjore dhe biologjike, këqyrja e tabulateve telefonike, marrja në pyetje e personave që kishin dijeni rreth çështjes, si dhe pas marrjes në pyetje të kërkuesit, i cili ka pranuar autorësinë e vrasjes së shtetasit K.B., në datën 08.02.2019, në përfundim të hetimeve, prokurori i ka njoftuar kërkuesit akuzën për veprat penale “Vjedhja” dhe “Vrasja me dashje”, të parashikuara respektivisht nga nenet 134/1 dhe 76 të *KP*-së, duke paraqitur kërkesë për dërgimin për gjykim të këtij procedimi penal.

2. Me vendimin nr. 441, datë 23.04.2019 të gjyqtarit të seancës paraprake, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për shqyrtimin në themel të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje” dhe “Vjedhja”, të parashikuara nga nenet 76 dhe 134/1 të *KP*-së. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për të proceduar me gjykim të shkurtuar, kërkim ky që është nuk është kundërshtuar nga prokurori.

3. Në seancën gjyqësore Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur refuzimin e kërkesës së bërë nga kërkuesi për të proceduar me gjykimin e shkurtuar, me arsyetimin se çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, duke u bazuar në kërkesat e nenit 403 dhe 405 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Ndërkohë, në seancën gjyqësore të datës 17.06.2020, në zbatim të nenit 372 të *KPP*-së, rezulton që nga ana e prokurorit t’i jetë komunikuar kërkuesit ndryshimi i akuzës nga “Vrasja me dashje”, e parashikuar nga neni 76 i *KP*-së, në “Vrasja me paramendim për interes”, e parashikuar nga neni 78, paragrafi i dytë, i *KP*-së. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor me procedurë të zakonshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2020-2700 (242), datë 28.07.2020, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale të vrasjes me paramendim për interes, si dhe atë të vjedhjes dhe, në bazë të neneve 78/2 dhe 134/1 të *KP*-së, dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 51, datë 11.03.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 62-2020-2700 (242), datë 28.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke e vlerësuar të drejtë atë. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-973 (153), datë 12.06.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 51, datë 11.03.2021 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Në datën 22.01.2026 (sipas shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 05.02.2026. Kolegji i Gjykatës në datën 23.04.2026 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuetit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

6.1. Refuzimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar është bërë në kundërshtim me nenin 405 të KPP-së, për faktin se nga ana e kërkuetit nuk ka pasur asnjë kërkesë për pavlefshmërinë e akteve, si dhe gjatë shqyrtimit nuk ka pasur marrje provash të reja, por është vijuar gjykimi vetëm mbi provat e parashtruara nga Prokuroria e Fierit në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Po kështu, ky mospranim i ritit të gjykimit të shkurtuar lidhet edhe me faktin se gjykata e shkallës së parë dhe Prokuroria Fier kanë ndryshuar cilësimin e veprës penale që i atribuohet atij, duke e paragjykuar çështjen.

6.2. Gjithashtu, megjithëse neni 406 i KPP-së është një dispozitë procedurale, në kushtet kur ajo lidhet dhe ndikon në ashpërsinë e dënimit, ajo merr trajtën e një dispozitë penale materiale, duke bërë që në rastin konkret të mos zbatohen mbi të dispozitat e ndryshimeve të bëra në KPP me ligjin nr. 35/2017, për shkak se fakti penal ka ndodhur përpara datës 01.08.2017, kur këto ndryshime kanë hyrë në fuqi. Aplikimi i dispozitës përpara ndryshimeve të KPP-së do t'i mundësonte atij që të mos dënohej me burgim të përjetshëm, por me 35 vjet burgim.

6.3. Nga ana e gjykatave të faktit dhe nga Kolegji Penal janë keq interpretuar provat që kanë çuar në ndryshimin e cilësimit të veprës penale, pasi në asnjë rast nuk vërtetohet paramendimi për kryerjen e veprës penale.

6.4. Po kështu, nga gjykatat e faktit nuk është hetuar për gjendjen psikike të tij, duke u bazuar vetëm në ekspertimin psikiatrik ligjor, kjo, në kushtet kur shkencërisht njihen edhe format e çrregullimeve psikike si skizofrenia, e cila mund të shfaqet edhe me një episod.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimimin e kërkesës

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës, përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

10. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kërkuesi, ka pretenduar se megjithëse neni 406 i KPP-së është një dispozitë procedurale, në kushtet kur ajo lidhet dhe ndikon në ashpërsinë e dënimit, ajo merr trajtën e një

dispozite penale materiale, duke bërë që në rastin konkret të mos zbatohen mbi të dispozitat e ndryshimeve të bëra në KPP me ligjin nr. 35/2017, për shkak se fakti penal ka ndodhur përpara datës 01.08.2017, kur këto ndryshime kanë hyrë në fuqi. Aplikimi i dispozitës përpara ndryshimeve të KPP-së do t'i mundësonte kërkuesit që të mos dënohej me burgim të përjetshëm, por me 35 vjet burgim.

12. Kërkuesi gjithashtu ka pretenduar se nga gjykatat e faktit nuk është hetuar në lidhje me gjendjen psikike të tij, duke u bazuar vetëm në ekspertimin psikiatrik ligjor, kjo, në kushtet kur shkencërisht njihen edhe format e çrregullimeve psikike si skizofrenia, e cila mund të shfaqet edhe me një episod. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ato nuk janë ngritur as në ankim dhe as në rekurs nga ana e kërkuesit, duke mos shteruar në këtë mënyrë të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese. Në këtë kontekst, këto pretendime të tij nuk mund të merren në shqyrtim.

13. Për sa u takon pretendimeve të tjera të tij, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi i ka ngritur ato në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke mos pasur mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, ndaj rezulton se kërkuesi e ka përmbushur këtë kriter.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 12.06.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 22.01.2026 (sipas shërbimit postar). Për qëllime të këtij shqyrtimi, Gjykatës së Lartë i është kërkuar informacion, e cila, në datën 13.02.2026, ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 22.09.2025. Për sa më sipër, ankimi kushtetues individual i kërkuesit është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, për pasojë legjitimohet *ratione temporis*.

16. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, rezulton se pretendimet e kërkuarit, në thelb, lidhen me mospranimin nga gjykata të ritit të gjyqimit të shkurtuar, ndaj Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar edhe në parimin *iura novit curia*, vlerëson që t'i trajtojë ato në kuadër të cenimit të parimit të mosdënimit pa ligj dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do të trajtohen në vijim.

17. Kërkuari ka pretenduar se refuzimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar është bërë në kundërshtim me nenin 405 të KPP-së, për faktin se nga ana e kërkuarit nuk ka pasur asnjë kërkesë për pavlefshmëri aktesh, si dhe gjatë shqyrtimit nuk ka pasur marrje provash të reja, por është vijuar gjykimi vetëm mbi provat e parashtruara nga Prokuroria e Fierit në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Po kështu, ky mospranim i ritit të gjyqimit të shkurtuar lidhet edhe me faktin se gjykata e shkallës së parë dhe Prokuroria Fier kanë ndryshuar cilësimin e veprës penale që i atribuohet atij, duke e paragjykuar çështjen.

18. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, për sa i takon ritit procedural të gjyqimit të shkurtuar, Gjykata ka pohuar se ai (gjykimi i shkurtuar) nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe, në rast se ai ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë kërkesën e të pandehurit (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Ndërsa në lidhje me karakteristikat e gjyqimit të shkurtuar, i cili hyn në kategorinë e gjyqimeve të posaçme, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime për këtë vlerësim, mund të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet nr. 56, datë 09.11.2023; nr. 6 datë 22.02.2022; nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Mbi bazën e këtyre standardeve kushtetuese, Mbledhja e Gjyqtarëve do të verifikojë nëse interpretimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka garantuar efektivitetin e së drejtës individuale me natyrë procedurale të gjykimit të shkurtuar, e cila është në funksion të parimit të mosdënimit pa ligj, të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës.

23. Duke u kthyer te çështja konkrete, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për sa i takon refuzimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, paraqitur nga kërkuesi, ka argumentuar se në rastin në gjykim ekzistonin dyshime për cilësimin e gabuar të veprës penale nga ana e Prokurorisë së Fierit dhe se mund të plotësoheshin kushtet kur mund të gjendeshin përpara veprave penale që parashikonin burgim të përjetshëm. Ndërkohë, në seancën gjyqësore të datës 17.06.2020, pas shqyrtimit dhe debatimit të provave me shkresë e me dëshmitarë, në zbatim të nenit 372 të KPP-së, rezulton që nga ana e prokurorit t'i jetë komunikuar kërkuesit ndryshimi i akuzës, nga "Vrasja me dashje", e parashikuar nga neni 76 i KP-së, në "Vrasja me paramendim" për interes, e parashikuar nga neni 78, paragrafi i dytë, i KP-së.

24. Gjykata e Apelit Vlorë, nga ana e saj, lidhur me mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, ka arsyetuar se e gjen të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila kishte vlerësuar se në rrethanat në të cilat ishte parashtruar fakti penal, nuk rezultonin të qarta elementet e veprës penale të vrasjes që lidhen me anën subjektive të saj, ç'ka do të sillte konsequencë në pamundësinë e cilësimit të drejtë juridik të veprës penale. Ajo gjykatë ka theksuar se dispozitat procedurale kanë njohur të drejtën e gjyqtarit të seancës paraprake e më tej të gjyqtarit që shqyrton çështjen në themel që të realizojnë në vijim një analizë të plotë dhe të drejtë të cilësimit juridik të veprës penale, duke i njohur mundësinë gjyqtarit të seancës paraprake për të ftuar prokurorin për të bërë një korrigjim të tillë në nenin 332/d të KPP-së, si dhe gjyqtarit të themelit të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale në nenin 375 të KPP-

së. Për më tepër, një të drejtë të tillë dispozitat procedurale ia kanë njohur edhe prokurorit për të ndryshuar akuzën në nenin 372 të KPP-së. Në vijim, ajo gjykatë vlerëson se pikërisht nevoja për një analizë të kujdesshme të akteve të paraqitura për gjykim, provave mbi të cilat bazohet akuza e ngritur ndaj të pandehurit, kërkon një dilijencë maksimale nga ana e gjykatës në shqyrtimin e kërkesës të të pandehurit për të vijuar shqyrtimin gjyqësor sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, me qëllim që një rit i tillë, ndërsa ndihmon në ekonominë gjyqësore, nuk duhet të bëhet pengesë për dhënien e një vendimi përfundimtar që nuk do të zgjidhte drejt përgjegjësinë penale të autorit të veprës.

25. Gjykata e Apelit Vlorë gjithashtu si argument shtesë për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar ka dhënë edhe faktin se ndryshimi i akuzës në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nga ana e prokurorit dhe më tej, deklarimi fajtor i të pandehurit për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim për interes, vepër kjo që parashikon si lloj dënimi edhe dënimin me burgim të përjetshëm, përbën pengesë ligjore për pranimin e kësaj kërkeje, referuar kjo edhe në ndryshimet e neneve 403 dhe 406 të KPP-së në kohën e shqyrtimit të çështjes.

26. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka vlerësuar të drejtë vendimin për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që e ka gjetur të gabuar arsyetimin e gjykatës së apelit se ligji procedural zbatohet menjëherë me hyrjen në fuqi të tij, pasi vepra penale ka ndodhur përpara muajit qershor 2017 kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet e KPP-së. Në këtë kontekst, arsyeton ajo gjykatë, e gjen të pabazuar referimin e saj në ndryshimet ligjore të KPP-së, pasi neni 406, pika 1, i këtij kodi, ndonëse është një dispozitë e parashikuar në ligjin procedural penal, lidhet me dënimin, prandaj, si e tillë, është një dispozitë penale materiale. Megjithatë, Kolegji Penal ka çmuar se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar për arsye se në vijim të mëtejshëm të procesit, pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmive, prokurori ka ushtruar të drejtën e parashikuar nga neni 372 i KPP-së, duke ndryshuar akuzën në ngarkim të të gjykuarit, nga vepra penale “Vrasja me dashje”, në veprën penale “Vrasja me paramendim” për interes, të KP-së. Kolegji Penal ka konstatuar se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm vendimmarrjen, duke konkluduar se provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova, kryerja e veprës penale “Vrasja me paramendim” për interes, të parashikuar nga neni 78 paragrafi dytë i KP-së, nga ana e kërkuarit.

27. Lidhur me sa më lart, rezulton se neni 404 i KPP-së i kohës, kur ka ndodhur fakti penal, parashikonte se gjykata e shqyrtonte këtë lloj kërkeje përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor dhe kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet vendos të pranojë gjykimin e shkurtuar. Në të kundërt, ajo e refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Ndërkohë neni 406 i KPP-së, që përcakton uljen e dënimit, ndonëse është një

dispozitë e parashikuar në ligjin procedural penal, lidhet me dënimin, prandaj, si e tillë, është një dispozitë penale materiale, materializuar kjo edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndërkohë, Gjykata ka vlerësuar gjithashtu se efektet që sjell gjykimi i shkurtuar, për sa i përket masës së dënimit dhe zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si rit procesual, influencon mbi masën ose llojin e dënimit që caktohet nga gjykata dhe, për rrjedhojë, kjo e drejtë procedurale ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtën materiale të mosdënimit pa ligj (*shih vendimin nr. 26, datë 29.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në përfundim të procesit gjyqësor arsyeja e refuzimit të gjykimit të shkurtuar lidhet me përcaktimin e cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria Fier dhe çështja është dërguar për gjykim. Lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale nga ana e Prokurorisë Fier, sikurse u përmend më lart, kjo e fundit, fillimisht e ka kualifikuar veprën si “Vrasja me dashje”. Gjykimi është zhvilluar me procedurë të zakonshme dhe ndonëse nuk janë marrë prova të reja në raport me ato të hetimit paraprak, provat, përfshirë ato me dëshmitarë, janë shqyrtuar dhe debatuar nga palët. Pas shqyrtimit të provave, prokurori, bazuar në nenin 372 të KPP-së, pasi ka konkluduar se fakti ka dalë ndryshe, e ka ndryshuar akuzën brenda kompetencave të tij procedurale pa marrë prova të reja. Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se gjykata e shkallës së parë, në referencë të arsyetimit të saj, ka përdorur vendimmarrjen unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara, si dhe një vendim të vet Gjykatës dhe, në këtë kontekst, kjo vendimmarrje është arsyetuar mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese.

29. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se gjatë gjykimit, nga ana e Prokurorisë Fier nuk janë paraqitur prova të reja që të ndikonin në ndryshimin e kualifikimit të veprës penale. Megjithatë, rezulton se gjykatat e faktit, mbi bazën e debatit të realizuar mbi provat ekzistuese, si dhe më pas, analizës së ndërthurur të provave shkresore dhe me dëshmitarë të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale, me dispozitën e veprës penale të vrasjes me paramendim për interes, kanë konkluduar se paramendimi provohet si elementi i anës subjektive të veprës penale. Me të drejtë në të njëjtin konkluzion ka arritur edhe Kolegji Penal, i cili e ka konsideruar të drejtë mospranimin e gjykimit të shkurtuar, por duke rrëzuar arsyetimin e gjykatës së apelit vetëm për sa i takon veprimin në kohë të ligjit procedural në rastin e gjykimit të shkurtuar. Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se vendimi për të pranuar ose jo kërkesën për gjykim të shkurtuar mbetet në çmimin dhe në bindjen e gjyqtarit të seancës, i cili, kur ka dyshime, mund të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme. Pikërisht, në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka pasur dyshime për cilësimin e veprës penale nga prokurori. Ky

dyshim i asaj gjykate ka rezultuar i mbështetur për sa kohë që është konkretizuar më tej edhe me ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga prokurori, referuar nenit 372 të KPP-së, për shkak se nga shqyrtimi gjyqësor i provave, fakti ka dalë ndryshe nga sa kishte kërkuar prokurori fillimisht në kërkesën për gjykim, duke e bërë kështu të drejtë vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi edhe nga gjykatat më të larta.

30. Në këtë optikë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se gjykatat e zakonshme i kanë interpretuar drejt normat procedurale penale që rregullojnë gjykimin e shkurtuar, duke mos sjellë cenim të së drejtës efektive kundër dënimit arbitrar në kuptim të së drejtës kushtetuese të mosdënimit pa ligj të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës. Në këtë kuadër, pretendimi i kërkuar për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit nga të tria shkallët e gjyqësorit është haptazi i pabazuar.

31. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.